



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4958
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 22/12.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.126

Datë: 12.12.2023

“Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkise Dibër dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2024”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me urdhër dhe Porosi

P/Sekretariati

Sara Karaj





4958/29/12/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1246/1 prot.

Peshkopi, më 27.12.2023

Lënda: Për vendimin nr.126, datë 12.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR


DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.126, datë 12.12.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve të varësisë për vitin 2024", vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre, të cilat në kuptim të nenit 13, pika 5, e ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", janë subjekte kontrolli nga KLSH-ja.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr.126 Datë 12.12.2023

“Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2024”

Mbështetur ne ligjin “139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, shkronja “c” dhe neni 9, të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vkm nr.326 date 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Vkm nr.241 datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr.175 date 08.03.2017 të këshillit të ministrave për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomesimore ne arsimin parauniversitar”, e ndryshuar vendimin nr.113, datë 01.03.2023, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë nëpërmjet këtij relacioni paraqesim para Këshillit Bashkiak kërkesën për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve të varësisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 12.12.2023, me 16 vota pro, 0 kundër dhe 11 apstenim:


VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve në varësi të saj për vitin 2024 sipas tabelave bashkëlidhur këtij projekt-vendimi.
2. Këshilltaret të shpërblehen në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë Dibër, ndërsa kryetarët e fshatrave të shpërblehen në masën:

- 4.4% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (0-300) banorë
- 6% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (301-600) banorë
- 7% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (601-1000) banorë
- 9% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (+1000) banorë
- 6% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (0-300) banorë
- 8% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (301-600) banorë
- 9% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (601-1000) banorë
- 10% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (+1000) banorë

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Personelit) dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër .
5. Efektet financiare i shtrin nga data 01.01.2024.
6. Vendimi u shpall me datë 21.12.2023.

Kryetare e Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBER
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës
PROJEKT-VENDIM

Nr. 28 Datë 01/12/2023

MIRATIMI I NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË DIBËR DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2024.

Mbështetur ne ligjin "139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, shkronja "c" dhe neni 9, të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", Vkm nr.326 date 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", Vkm nr.241 datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në vendimin nr.175 date 08.03.2017 të këshillit të ministrave për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomesimore ne arsimin parauniversitar",e ndryshuar vendimin nr.113, datë 01.03.2023, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë nëpërmjet këtij relacioni paraqesim para Këshillit Bashkiak kërkesën për miratimin e nivelit te pagave te Bashkisë Dibër dhe institucioneve te varësisë.

KËRKOJMË:

1. Miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Dibër dhe institucioneve në varësi të saj per vitin 2024 sipas tabelave bashkëlidhur këtij projekt-vendimi.
2. Këshilltaret të shpërblehen në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë Dibër, ndërsa kryetarët e fshatrave të shpërblehen në masën:
 - 4.4% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (0-300) banorë
 - 6% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (301-600) banorë
 - 7% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (601-1000) banorë
 - 9% të pagës së Administratorit {5.000-20.000 banorë } (+1000) banorë

- 6% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (0-300) banorë
- 8% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (301-600) banorë
- 9% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (601-1000) banorë
- 10% të pagës së Administratorit {0-5000 banorë } (+1000) banorë

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Personelit) dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Dibër .
5. Efektet financiare i shtrin nga data 01.01.2024

PËR BASHKINË DIBËR :

Drejtori Juridik

Ismet Saraçi

Përgjegjës i Burimeve Njerzore

Malbona Lala

Drejtori Ekonomik

Çeljeta ZUNA

Përgjegjës finance

Antike TORBA

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me porosi

Nënkryetari i bashkisë

Ruzhdi DEDA

